



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivery	24.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	2984/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.344/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.344/2023 të datës 09.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, me adresë banimi: Rruga "Afrim Zhitia", në Mitrovicë, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.344/2023 e datës 09.02.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Anulohet Masa disiplinore "Vërejte me shkrim" e shqiptuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës të datës 12.01.2023.

III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, me qëllim të deklarimit të shuarjes dhe largimit të masës disiplinore nga dosja e ankuesit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], sipas shkresave të lëndës i punësuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinim në Rajonin e Mitrovicës në Inspektoratin e Punës, me datë 08.02.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është regjistruar me datë 09.02.2023 me shenjen A.nr.344/2023 dhe numër protokolli 1656/2023, kundër masës disiplinore "vërejte" të shqiptuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës të datës 12.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 16.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te Inspektorati i Punës, ndërsa me datë 16.03.2023 përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar se të gjitha provat e kërkuara i posedoni në Këshill pasi që ankuesi për të njëjtën çështje ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 07.11.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritok ka administruar këto prova: Ankesën me shenjen A.nr.344/2023 me numër të protokollit 1656/2023 të parashtruar nga ankuesi me datën 09.02.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e ankuesit të datës 08.02.2023; Vërejtje me shkrim e datës 12.01.2023 e shqiptuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës; Vendim i datës 18.01.2023 me nr.01/2023 për deklarimin e shuarjes së masës disiplinore; Vendimi A.nr.977/2022 i datës 21.12.2022 me numër protokolli 8282/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 05.11.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mali zyrtar i datës 29.09.2022; E-mali zyrtar i datës 29.09.2022 –kërkesë për njoftim; E-mali zyrtar i datës 03.10.2022- njoftim; Mesazh i datës 06.10.2022 –raport për muajin shtator –vërejtje; E-mali zyrtar i datës 24.10.2022- kërkesë; E-mali zyrtar i datës 24.10.2022; shenjat mjekësore të datës 21.10.2022; Konfirmimi i pranimit të ankesës së ankuesit përmes e-mailit të datës 09.02.2023; E-mali zyrtar i datës 16.03.2023 nga zyra e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të punës ; Njoftimi nga Zyra e Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e punës për Këshillin dhe Vendimi i datës 18.01.2023 me nr.01/2023 për deklarimin e shuarjes së masës disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar *sepse*:

Ankuesi për të njëjtë çështje me datë 07.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6749/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vërejtjes të shqiptuar me datën 06.10.2022 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës për raportin e muajit shtator. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendimin e datës 21.12.2022 me numër protokolli 8282/2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën A.nr.977/2022 të datës 07.11.2022, ka shfuqizuar vërejtjen e shqiptuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës dhe ka obliguar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi. Me datën 25.01.2023 Menaxheri i Personelit të Inspektoratit të Punës ka njoftuar Këshillin se me vendimin e datës 18.01.2023 është larguar masa disiplinore nga dosja personale e ankuesit duke u bazuar në vendimin A.nr.977/2022 të datës 21.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin, ndërsa me vendimin e datës 12.01.2023 Kryeinspektori

i Inspektoratit të punës ankuesit [redacted] i shqipton masën disiplinore vërejtje me shkrim për arsye të mos përgatitjes të raportit për muajin shtator. Si rrjedhojë Kolegji e konsideron që vendimi i Këshillit nuk është zbatuar ashtu siç parashihet me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, i cili përcakton se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*.

Ankuesi më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill pretendon se i njëjti nuk ka mundur të përgatit raportin e punës për muajin shtator pasi që ka shkuar në pushim mjekësor nga data 29 shtator, ndërsa data 30 shtator ka qenë ditë punë dhe nuk ka mundur të dërgohet raporti pa përfunduar komplet muaji, po ashtu inspektorët e punës kanë afat që të raportojnë deri me datën 5 të muajit vijues, po ashtu ankuesi e kishte caktuar zëvendësuesin e tij me rastin e hapjes së pushimit mjekësor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me kompetencën ligjore të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, thekson faktin se Këshilli ka nxjerrë Vendimin Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 përmes të cilit e kishte aprovuar Raportin e Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe kishte konstatuar se Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës ishte emëruar në mënyrë të kundërligjshme nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit Nr.01/79 të datës 25.05.2022, respektivisht me rastin e emërimit të të njëjtit ishte vepruar në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që nuk ishte zhvilluar procedurë e rregullt e rekrutimit siç përcaktohet me dispozitat e ligjit material, rrjedhimisht Vendimi i Këshillit me numër Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 është bërë i ekzekutueshëm, ngase Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktvendimit 1892/2022 të datës 22.08.2022 e kishte refuzuar kërkesën e palës paditëse, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për aprovimin e masës së sigurisë apo shtyrjes së ekzekutimit të Vendimit të Këshillit, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se masa e shqiptuar disiplinore *"Vërejtje me shkrim"* me vendimin e datës 12.01.2023 ndaj ankuesit, në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë"* është shqiptuar nga personi jo kompetent dhe si e tillë është e kundërligjshme, andaj e njëjta është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, me rastin e pranimit të Vendimit të Këshillit, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nenin 51 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Deklarimi i shuarjes bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Masa fshehet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës."* duhet të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim që masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit të shuhet dhe e njëjta të largohet nga dosja personale e ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetim të këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,



nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.344 /2023,

Sabile AVDYL

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, [REDACTED]
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së